

VENDIM
Nr. 676, datë 30.10.2024

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “ZGJERIMI I VARREZAVE TË QYTETIT FUSHË-KRUJË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave të qytetit Fushë-Krujë”.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Krujë.
 3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 624 512 (gjashtëqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e dymbëdhjetë) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 624 512 (gjashtëqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e dymbëdhjetë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Krujë.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Krujë.
 6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
 7. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Krujë.
 8. Bashkia Krujë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
 9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Krujë.
 10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Krujë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Krujë për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.
 11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Krujë për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.
 12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Krujë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Krujë, Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Durrës dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Lista emërore përfundimtare e pronarëve, pasuri e paluajtshme, pronë private, që shpronësohen për interes publik, nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave të qytetit Fushë-Krujë”

Nr.	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)							Vlerësimi për shpronësim				
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	Vlera totale në (lekë)	Shënime
1	Shpetim	Shaban	Babaj	Fshat Fushë-Krujë, Krujë	1665	247/3	Arë	2000	4	16	2000	287	574000	574000	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Saba	Haxhi	Tali	Fshat Fushë-Krujë, Krujë	1665	246/6	Arë	4600	5	56	3	287	861	861	Konfirmuar nga ASHK-ja
3	Saba	Haxhi	Tali	Fshat Fushë-Krujë, Krujë	1665	246/7	Arë	4000	5	54	173	287	49651	49651	Konfirmuar nga ASHK-ja
VLERA TOTALE														624,512	
Çmimet janë marrë nga harta e vlerës, miratuar me VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016.															